



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

# UDHËZUES

AKKSHI

PËR

PROJEKTE TË TEKNOLOGJISË DHE

INOVACIONIT (PTI)

(Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin)

Viti 2025

## PËRMBAJTJA

<b>KREU I.....</b>	<b>3</b>
<b>QËLLIMI, SYNIMI, OBJEKTIVAT DHE KRITERET E PRANUESHMËRISË .....</b>	<b>3</b>
1.1. Rreth Programit të Teknologjisë dhe Inovacionit.....	3
1.2. Qëllimi .....	3
1.3. Synimi i PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin) .....	3
1.4. Objektivat e programit PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin).....	3
1.5. Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve .....	4
<b>KREU 2.....</b>	<b>4</b>
<b>PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE.....</b>	<b>4</b>
2.1. Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte.....	4
2.2. Organizimi i ditëve informative.....	5
2.3. Dokumentacioni i aplikimit .....	5
2.4. Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit .....	5
2.5. Shqyrtimi i dosjes së aplikimit .....	5
2.6. Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit.....	5
2.7. Njoftimi i fituesve.....	6
<b>KREU 3.....</b>	<b>6</b>
<b>VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE.....</b>	<b>6</b>
3.1. Qëllimi i vlerësimit dhe miratimit të projekteve:.....	6
3.2. Procesi i vlerësimit .....	6
3.3. Procedura e miratimit për financim të projekteve.....	6
<b>KREU 4.....</b>	<b>7</b>
<b>ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E TYRE</b>	<b>7</b>
4.1. Financimi i projekteve fituese .....	7
4.2. Buxheti i detajuar.....	7
4.3. Raportimi .....	8
4.3. Raporti përfundimtar .....	8
<b>KREU 5.....</b>	<b>9</b>
<b>MONITORIMI I PROJEKTEVE.....</b>	<b>9</b>
5.1. Qëllimi i monitorimit.....	9
5.2. Fazat e monitorimit.....	9
5.3. Detyrimet e përfituesit.....	9
5.4. Raportet e monitorimit AKKSHI.....	10
<b>KREU 6.....</b>	<b>10</b>
<b>ETIKA, PRONËSIA INTELEKTUALE, KONFLIKTI I INTERESTIT DHE KONFIDENCIALITETI</b>	<b>10</b>
6.1. Etika dhe Integriteti i Kërkimit.....	10
6.2. Pronësia Intelektuale.....	10
6.3. Konflikti i interesit dhe konfidencialiteti.....	11
<b>KREU 7.....</b>	<b>11</b>
<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....</b>	<b>11</b>
7.1. Kohëzgjatja e projektit.....	11
7.2. Forma/fokusi i PTI.....	11

## **KREU I**

### **QËLLIMI, SYNIMI, OBJEKTIVAT DHE KRITERET E PRANUESHMËRISË**

#### **1.1. Rreth Programit të Teknologjisë dhe Inovacionit**

Programi i financimit të projekteve të bashkëpunimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë me industrinë dhe biznesin synon intensifikimin e bashkëpunimit midis biznesit dhe komunitetit të kërkimit shkencor nëpërmjet granteve të përbashkëta për zgjidhjen racionale të problematikave të zhvillimit të biznesit në transferim teknologjie dhe inovacion, në kuadër të zbatimit të objektivave strategjike kombëtare në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Ai është në një linjë edhe me prioritetet strategjike të Zonës Europiane të Kërkimit (ERA) dhe kërkesat e integritit europian të vendit.

Financimi i projekteve të përbashkëta që vijnë si bashkëpunime të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë me industrinë dhe biznesin kanë për qëllim ndërtimin e lidhjeve më të ngushta ndërmjet biznesit dhe universiteteve në mënyrë që të bashkëprodhojnë njohuri dhe kërkime me një ndikim jo vetëm akademik, por edhe të zbatueshëm për zhvillimin e Shqipërisë në një linjë me kërkesat e integritit europian dhe sfidave të shumta aktuale.

#### **1.2. Qëllimi**

Ky udhëzues shërben për projektet e përbashkëta që vijnë si bashkëpunime të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë me industrinë dhe biznesin në kuadër të fondit të Teknologjisë dhe Inovacionit. Projektet e Teknologjisë dhe Inovacionit (këtu e në vijim PTI - Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin) realizohen mbi baza bashkëfinancimi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) me grant të buxhetit të shtetit dhe të sipërmarrjeve të industrisë dhe biznesit, dhe administrohen nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Qëllimi i programit është të intensifikojë përpjekjet për kërkim dhe zhvillim (R&D), të forcojë ndërlidhjen midis institucioneve të arsimit të lartë dhe industrisë dhe të përshpejtojë zhvillimin nga faza laboratorike në fazën pilot, duke i bërë ato të përshtatshme për komercializim.

#### **1.3. Synimi i PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin)**

Synimi i PTI është promovimi dhe mbështetja e projekteve të përbashkëta të komunitetit të kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë me industrinë dhe biznesin, në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe me tendencat e zhvillimeve globale, duke e vënë punën kërkimore-shkencore në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit.

#### **1.4. Objektivat e programit PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin)**

Objektivat e programit janë:

- a. Të mbështesë kërkimin shkencor dhe inovacionin në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale sipas fushave prioritare të miratuara nga MAS.

- b. Të nxisë inovacionin dhe zhvillimin teknologjik nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë me komunitetin e industrisë dhe biznesit;
- c. Të vendosë kërkimin shkencor në qendër të zgjidhjes së problemeve të biznesit dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit;

### **1.5. Kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve**

1. Të drejtën për të aplikuar me projekte të përbashkëta PTI (që vijnë si bashkëpunime të institucioneve të arsimit të lartë (IAL-ve) me biznesin, e kanë IAL që, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, zhvillojnë kërkim shkencor.
2. Aplikuesi i parë do të jetë një IAL i përcaktuar si i tillë në pikën 4, të Nenit 4, të Ligjit Nr. 80/2015, në partneritet me një biznes, partneriteti i cili sanksionohet me një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre. Pjesë e marrëveshjes duhet të jetë bashkëfinancimi në raportin 70% financim grant nga AKKSHI dhe 30% financim nga biznesi.
3. Aplikant i dytë i referuar si partner nga biznesi, duhet:
  - a) Të jetë i organizuar dhe të funksionojë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, specifikisht me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2018 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
  - b) Të ketë selinë dhe të ushtrijë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - c) Të shprehë qartë përfitimin nga projekti i propozuar në partneritetet me kërkusit shkencor pjesë e IAL dhe të dëshmojë kapacitete në mbështetje të projektit;
4. Projektet duhet të synojnë zhvillimin e një produkti/procesi/shërbimi të ri, ose përmirësime të dukshëm në një produkt/proces ekzistues/shërbim, me potencial tërheqës tregu.
5. Projekt propozimi duhet të mbështetet mbi një Plan Biznesi me specifikime të qarta lidhur me rezultatet e pritshme të projektit.
6. Projekt propozimi duhet të përputhet me prioritetet strategjike kombëtare dhe sektoriale të miratuara nga Qeveria Shqiptare, sipas fushave të mësipërme.
7. Projekt propozimi duhet të vijë nga një grup kërkuesish në një IAL sipas përcaktimeve të mësipërme, në përputhje me kërkesat e udhëzuesit përkatës të PTI;
8. Projekt propozimi duhet të përmbajnë vetëm veprimtari që lidhen me kërkim&zhvillimin, duke përfshirë blerjen e pajisjeve, etj. Infrastruktura e nevojshme ofrohet nga biznesi si partner aplikues;
9. Objektivat e projekt propozimit duhet të synojnë:
  - a) Zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovative;
  - b) Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë dhe biznesit;
  - c) Lehtësimin e komercializimit të produktit;
  - d) Projekti duhet të ketë në bazë veprimtarinë kërkimore që ka për synim: (i) përmirësimin e zinxhirit të vlerës, (ii) përmirësimin e produktit; (iii) përmirësimin e shërbimit apo të zhvillojnë konceptin e biznesit për një produkt apo shërbim që është i gatshëm të dalë në treg, në përputhje me strategjinë e rritjes e fuqizimit të kompanisë.
10. Në thirrjen për aplikime që miratohet nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, mund të përcaktohen edhe kritere të tjera përveç atyre të sipërpërmendur.

## **KREU 2**

### **PROCEDURA E PARAQITJES, SHQYRTIMIT DHE PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE**

#### **2.1. Shpallja e thirrjes për aplikim për projekte**

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit me vendim të Bordit të Administrimit (BA) miraton hapjen e thirrjes për aplikim me projekte të PTI (projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin). Vendimi i BA publikohet në faqen zyrtare web të AKKSHI dhe është i aksesueshëm për gjithë të interesuarit. Gjithashtu MAS informon IAL mbi thirrjen e shpallur.

## 2.2. Organizimi i ditëve informative

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, gjatë periudhës kur “Thirrja” qëndron e hapur, organizon ditë informative me kërkuesit shkencorë të institucioneve dhe IAL-ve si dhe me përfaqësues të biznesit potencialisht të interesuar për thirrjen. Ditët informative organizohen me qëllim qartësimin e specifikimeve të thirrjes si dhe për t’ju përgjigjur pyetjeve që mund të kenë personat e interesuar për të marrë pjesë me projekt propozime në kuadrin e një thirrje të caktuar.

## 2.3. Dokumentacioni i aplikimit

Dokumentacioni për aplikim për projekte hartohet nga AKKSHI dhe është i aksesueshëm në faqen zyrtare web të institucionit për të gjithë institucionet që janë të interesuar dhe kanë të drejtën të aplikojnë për projekte të PTI.

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në AKKSHI nëpërmjet protokollit në 2 (dy) kopje fizike dhe 1 (një) kopje në formë elektronike. Projekt propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Formës së Aplikimit të Projektit për Bashkëpunim IAL-Biznes (Aneks 1) dhe Formës së Propozimit Financiar (Aneks 2). Sqarimet për mënyrën e plotësimit të Dokumentit të projekt propozimit gjenden në (Aneks 2/1), si dhe detajohen në Ditët Informative që AKKSHI organizon për gjithë të interesuarit. Lista e dokumentacionit shoqërues të projekt propozimit përcaktohet e detajuar në thirrjen e miratuar nga BA.

## 2.4. Afati i dorëzimit të dosjes së aplikimit

Dosja e aplikimit me projekt propozimin, duhet të depozitohet në AKKSHI brenda afatit të përcaktuar në Thirrjen për aplikim të shpallur nga AKKSHI.

Përcaktimi i afateve për depozitim të aplikimit kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 53 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”. Llogaritja e afateve të depozitimit të dosjes së aplikimit pranë AKKSHI, kryhet në përputhje me përcaktimet e neneve 56 dhe 57 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Aplikuesi mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, në përputhje me nenet 54 dhe 55 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”.

## 2.5. Shqyrtimi i dosjes së aplikimit

Në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, kontrolli formal bëhet nga Drejtoria e Programeve Kombëtare, në Sektorin e Teknologjisë dhe Inovacionit, që administron PTI (Projekte që vijnë si bashkëpunim i Universitetit me Biznesin).

Ai synon të vlerësojë nëse projekt propozimi është propozuar në fushën përkatëse, nëse përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar të plotësuar sipas kërkesave të këtij udhëzuesi dhe të thirrjes së miratuar nga Bordi i Administrimit të AKKSHI.

Projekt propozimet që nuk kanë dokumentacion të plotë, kanë pasaktësi në plotësim, apo që nuk përmbushin kriteret dhe formatin e përcaktuar nga AKKSHI, skualifikohen që në fazën e shqyrtimit formal.

## 2.6. Përzgjedhja e projekteve që përmbushin kërkesat e aplikimit



Projekt propozimet të cilat i janë përmbajtur kritereve administrative të vendosura nga AKKSHI së bashku me dokumentacionin përkatës, kalojnë në procesin e vlerësimit teknik nga komisionet e vlerësimit të projekteve.

## 2.7. Njoftimi i fituesve

Pasi vlerësohen nga komisionet e ekspertëve të vlerësimit dhe pasi miratohen nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, projektet të cilat shpallen fituese njoftohen me shkresë zyrtare dhe gjithashtu vendimi i miratuar nga BA me listën e publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të AKKSHI.

## KREU 3 VLERËSIMI DHE MIRATIMI I PROJEKTEVE

### 3.1. Qëllimi i vlerësimit dhe miratimit të projekteve:

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të drejtimit të çdo aktiviteti shkencor. Atij i nënshtrohen të gjitha projektet për Bashkëpunim IAL-Biznes.

Ai nevojitet për të evidentuar gjendjen reale të ecurisë së projekteve dhe për të përcaktuar masa konkrete për përmirësimin e saj, për të nxjerrë përfundime të drejta lidhur me vlerën e vetë projekteve, rezultatit shkencor të projektit, problemet administrative, financiare si dhe mësimet në lidhje me projektet e ardhshme. Ai synon të vlerësojë nëse projekt propozimi është formuluar në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit<sup>1</sup> për të gjitha fushat prioritare.

### 3.2. Procesi i vlerësimit

- a. Procesi i vlerësimit fillon me kontrollin teknik formal e administrativ që kryhet nga stafi i Drejtorisë së Programeve Kombëtare në AKKSHI dhe synon përmbushjen e kritereve të aplikimit dhe të dokumentacionit që aplikantët kanë paraqitur.
- b. Projekt propozimet që kalojnë fazën e parë i përcillen për ekspertizë Komisionit të Ekspertëve, që bën vlerësimin përmbajtësor e shkencor të tyre.
- c. Komisioni i ekspertëve për kryerjen e vlerësimit përmbajtësor e teknik të projekt propozimeve, miratohet nga Bordi i Administrimit i AKKSHI-t pas një procesi të hapur aplikimesh nga kandidatët. Anëtarët e tij zgjidhen nga specialistë të fushave përkatëse dhe nuk janë pjesë e personelit të projektit ose të organeve vendimmarrëse të institucioneve që e kanë propozuar atë.
- d. Procesi i vlerësimit bëhet në përputhje me Skedën e Vlerësimit të Projekteve.
- e. Komisioni i Ekspertëve përpara fillimit të procesit të vlerësimit, nënshkruan Deklaratën e Konfliktit të Interesit dhe të paanshmërisë dhe integritetit profesional.
- f. Eksperti i vlerësimit shpërblehet për punën e kryer bazuar në VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”. Në grupin e vlerësimit nuk përfshihen persona të cilët kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në aktet e hartimit, miratimit, zbatimit dhe drejtimit të projektit.

### 3.3. Procedura e miratimit për financim të projekteve

Procesi i miratimit për financim të projektit kalon përmes këtyre hapave:

<sup>1</sup> Strategjitë Kombëtare dhe Sektoriale. Prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe të MAS

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Rr. "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë. <https://nasri.gov.al/>

- a) Vlerësimet e Komisionit të Ekspertëve i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t me procesverbalin përkatës të mbajtur nga çdo komision dhe listën rankuese të firmosur nga ekspertët vlerësues. Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI përcjellë listën e sipërpërmendur për përzgjedhjen dhe miratimin e projekteve fituese në Bordin e Administrimit.
- b) Për projekt-propozimet që janë miratuar për financim nga Bordi i Administrimit, lidhet kontrata sipas modelit bashkëlidhur ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI dhe institucionit shkencor që ka paraqitur kërkesën, të përfaqësuar nga drejtuesi i tij dhe drejtuesi i projektit.

## KREU 4

### ASPEKTE FINANCIARE TË PROJEKTEVE FITUESE DHE RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E TYRE

#### 4.1. Financimi i projekteve fituese

- a. Pas vlerësimit nga ekspertët e Komisioneve të vlerësimit, miratimit të projekteve fituese në Bordin e Administrimit dhe lidhjes së kontratës, përfituesi do të marrë fondin e përcaktuar, brenda një afati jo më të gjatë se 45 ditë pas shpalljes së vendimit për financimin e projektit.
- b. Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga Bordi i AKKSHI-së. Kërkesa duhet të dërgohet të paktën 15 (ditë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Bordi i AKKSHI-së. AKKSHI-ja njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë së përfituesit.
- c. Kërkesa për shtyrje të afatit të përfundimit të projektit dhe të dorëzimit të raportit përfundimtar miratohet nga AKKSHI pas shqyrtimit të argumentave të parashtruara nga kërkuesi.
- d. Kërkesa duhet të dërgohet të paktën 15 (ditë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga Bordi i AKKSHI-së.
- e. Ndryshimet në zërat buxhetore lejohen deri në një total prej 10 % të fondit të financuar nga AKKSHI-ja, **vetëm** brenda të njëjtit zë dhe mund të bëhen **vetëm** me miratimin paraprak të AKKSHI. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AKKSHI-në duke argumentuar që ndryshimet e kërkuara nuk ndikojnë në cilësinë e realizimit të projektit dhe janë propozuar në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.
- f. Përfituesi i grantit ka të gjithë përgjegjësinë ligjore lidhur me zbatimin e projektit sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe përcaktimeve të këtij udhëzimi.

#### 4.2. Buxheti i detajuar

- a. Projekt – propozimet vijnë si bashkëfinancim në raportin 70% financim grant AKKSHI dhe 30% financim nga sipërmarrja/biznesi. Pas miratimit për financim nga BA, drejtuesi i projektit risjell Planin e Financimit të detajuar të projektit. Të gjitha shpenzimet e planifikuara duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit.
- b. Granti i AKKSHI mbulon:
  - i. pagesat e personelit të angazhuar në grupin e punës së projektit **vetëm** për anëtarët e grupit që janë pjesë e institucionit kërkimor shkencor dhe **jo për anëtarët përfaqësues të biznesit**. Këto pagesa duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi<sup>2</sup> dhe duhet t'i referohen kontratës të punës që çdo anëtar i projektit ka në IAL që aplikon për projektin. Numri i ditëve të punës, si për drejtuesin ashtu edhe për secilin prej anëtarëve të grupit të përfshirë në projekt, nuk mund të kalojnë limitin prej 40 ditë pune/vit.

<sup>2</sup> Udhëzimi nr.29, datë/10/9/2018, " Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Rr."Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë. <https://nasri.gov.al/>

- ii. shpenzime për udhëtime dhe dieta, **vetëm** për anëtarët e grupit që janë pjesë e institucionit kërkimor shkencor dhe jo për anëtarët përfaqësues të biznesit. Shpenzimet duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor përkatës për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit. Aplikanti do të duhet të argumentojë udhëtimet në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe objektivave të projektit. Gjatë implementimit të projektit, shpenzimet e udhëtimit do të justifikohen me dokumentat përkatëse. Janë shpenzime të lejuara vetëm ato që lidhen me mobilitetin brenda vendit.
  - iii. publikime, ku përfshihen botime artikujsh shkencorë sipas specifikimeve të kuadrit ligjor përkatës, si dhe botime shkencore të tjera si: revista /buletine/monografi/libra/prezantime në konferenca shkencore të botuara në përmbledhjet e tyre/ etj. të cilat prodhohen për nevoja dhe në kuadër të projektit, apo shpenzimet në rast të aplikimit për patentë. Aplikanti duhet të vendosë logon e AKKSHI-së në të gjithë dokumentat/botimet e prodhuara në kuadër të projektit, si dhe në të gjitha aktivitetet që janë financuar nga AKKSHI.
- c. Granti i AKKSHI **nuk** mbulon:
- i. shpenzimet administrative të tilla si: qera sallash; karburant makine, etj. Të gjitha shpenzimet administrative do të mbulohen nga kontributi i biznesit partner ose institucioni i arsimit të lartë që ka aplikuar.
  - ii. pagesa personeli dhe mobiliteti të përfaqësuesve të biznesit apo mobilitet të huaj.
  - iii. shpenzimet e mëposhtme, të cilat nuk janë as të lejueshme:
    - Blerje e tokës.
    - Shit-blerje makinash.
    - Interes mbi huadhënie.
    - Marrëveshje huadhënie.
    - Dhurime.
    - Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
    - Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit.
    - Nënkontraktimi i subjekteve private
    - Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

### 4.3 Raportimi

- a. Për projektet dorëzohet raport i ndërmjetëm në përfundim të vitit të parë të zbatimit të projektit, i cili duhet të depozitohet në AKKSHI me shkresë përcjellëse të titullarit të institucionit përfitues. Raporti duhet të pasqyrojë realizimin e aktiviteteve dhe të shpenzimeve të planifikuara. Mënyra e paraqitjes së raportit vjetor duhet të jetë sipas formatit të AKKSHI.
- b. Në përfundim të realizimit të projektit, të gjithë përfituesit dorëzojnë raportin përfundimtar.

### 4.4 Raporti përfundimtar

- a. Në përfundim të çdo projekti për kërkim e zhvillim përpilohet raporti shkencor (studimi) përkatës. Ky raport, si dhe dokumente të tjera që përcaktohen në këtë udhëzim i paraqiten institucionit financues përgjegjës brenda afatit të parashikuar për përfundimin e projektit.
- b. Raporti shkencor (studimi) paraqitet sipas strukturës së mëposhtme:



- i. Kopertina sipas modelit bashkëlidhur.
  - ii. Përmbajtja e lëndës, ku jepet emërtimi i kapitujve e nënkapitujve dhe numri i faqeve përkatëse.
  - iii. Lista e shkurtimeve të termave të përdorura (Faqe më vete).
  - iv. Lista e ilustrimeve (figura, grafikë, harta, skica, etj.) (Faqe më vete).
  - v. Hyrja.
  - vi. Rezultatet shkencore të projektit.
  - vii. Përfundime.
  - viii. Rekomandime.
  - ix. Literatura.
  - x. Oponencat shkencore të projektit (dy).
- c. Bashkë me raportin shkencor (studimin) duhet të dërgohen gjithashtu:
- i. Situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas pasqyrave bashkëlidhur duke plotësuar kolonën e shpjegimeve me komentet/përshkrimet e nevojshme.
  - ii. Tabelë përmbledhëse me të dhëna për projektin e financiar
  - iii. Kopje të faturave për shpenzimet e bëra gjatë periudhës të zbatimit të projektit.
  - iv. Raportin e auditimit financiar të projektit nga strukturat përkatëse të institucionit përfitues.
  - v. Skeda informative sipas modelit bashkëlidhur.

## KREU 5 MONITORIMI I PROJEKTEVE

### 5.1. Qëllimi i monitorimit

- a. Procesi i monitorimit fokusohet në dy drejtime kryesore:
  - i. në verifikimin e zbatimit të projektit sipas planit të miratuar për financim;
  - ii. në shqyrtimin e raporteve të drejtuesve të projekteve mbi ecurinë e projekteve.
- b. AKKSHI nuk ka funksion të saj auditimit financiar të fondeve që ka përfituar institucioni i arsimit të lartë nga granti përkatës apo të procedurave prokuruese.

### 5.2. Fazat e monitorimit

- a. Monitorimi i projekteve gjatë zbatimit të tyre realizohet nga AKKSHI mbi bazë kërkesë dhe sipas nevojës.
- b. Nëse e shih të arsyeshme, AKKSHI kryen edhe monitorim fizik përmes vizitës në insitucionin përfitues.
- c. Monitorimi përfundimtar realizohet nga AKKSHI pasi përfituesi ka dorëzuar raportin përfundimtar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim.
- d. Në rastin kur, pas shqyrtimit të raportit përfundimtar, rezultojnë pasaktësi apo mungesë dokumentacioni, AKKSHI njofton me shkresë zyrtare përfituesin me kërkesën për plotësim.
- e. Përfituesi përcjell në AKKSHI raportin përfundimtar (së bashku me dokumentacionin plotësues) të rishikuar jo më vonë se 10 ditë pune nga marrja e kërkesës.
- f. Institucioni i arsimit të lartë përfitues i grantit mban përgjegjësi të plotë lidhur me ndjekjen e procesit dhe të procedurave të realizimit të projektit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe për raportimin në kohë dhe sipas kërkesave të AKKSHI.

### 5.3. Detyrimet e përfituesit

Në procesin e monitorimit përfituesi ka detyrim:

- a. të mundësojë aksesin në institucion për ekspertët e AKKSHI për monitorim fizik pas kërkesës dhe njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI.
- b. të japë informacion periodik mbi realizimin e projektit sa herë dhe në mënyrën që i kërkohet nga AKKSHI;
- c. të hartojë raportin (periodik dhe përfundimtar) në afat dhe përputhje me modelin, kërkesat, dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga AKKSHI.

#### 5.4. Raportet e monitorimit AKKSHI

Pas përfundimit të procesit të monitorimit, AKKSHI harton raportin përmbledhës me konstatimet dhe gjetjet përkatëse për çdo projekt të financuar.

### KREU 6

## ETIKA, PRONËSIA INTELKTUALE, KONFLIKTI I INTERESTIT DHE KONFIDENCIALITETI

### 6.1. Etika dhe Integriteti i Kërkimit

- a. Aplikantët duhet të respektojnë parimet kryesore të etikës shkencore dhe asaj profesionale.
- b. Procesi i kërkimit si dhe studimi shkencor/artikujt shkencorë/ botimet shkencore/ instrumentat e kërkimit/dokumentat /etj, që do të prodhohen në kuadër të këtij projekti, do të jenë në përputhje me parimet e kodit të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor kombëtar dhe europian lidhur me etikën në kërkimin shkencor<sup>3</sup>, si më poshtë vijon:
  - i. Respektimi i dinjitetit dhe integritetit njerëzor;
  - ii. Sigurimi i ndershmërisë dhe transparencës ndaj subjekteve kërkimore dhe veçanërisht marrja e pëlqimit dhe informimit;
  - iii. Sigurimi i privatësisë dhe konfidencialitetit;
  - iv. Promovimi i drejtësisë dhe i gjithëpërfshirjes;
  - v. Minimizimi i dëmit dhe përfitimi maksimal;
  - vi. Respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe gjeneratave të ardhshme.
  - vii. Të tjera.

### 6.2. Pronësia Intelktuale

<sup>3</sup> Konsiderohen shkelje të rënda të integritetit në kërkimin shkencor: fabrikimi ose sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta; falsifikimi manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja/shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i njëpunimi ose botimi si me vlera shkencore, pa qenë i tillë; plagjiatura ose përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale; pranimi dhe/ose paraqitja e punimeve pranë një organi haptazi jo kompetent a i pa autorizuar në fushën përkatëse; manipulimi i autorësisë; autoplagjiatura; citimi përzgjedhës; fshehja e pjeshme e rezultateve të kërkimit; lejimi i financuesve/sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve; keqprezantimi i arritjeve të kërkimit; themelimi ose mbështetja e revistave a botimeve të tjera grabitqare; fshehja e konfliktit të interesit etj.

#### Referenca:

- a. European Code of Conduct for Research Integrity-2017, burimi: <https://www.allea.org/wp-content/uploads/2017/05/ALLEA-European-Code-of-Conduct-for-Research-Integrity-2017.pdf>.  
I përkthyer në gjuhën shqipe, në linkun: [https://www.allea.org/wp-content/uploads/2018/06/ALLEA-ALbanian-European-Code-of-Conduct-for-Research-Integrity\\_FINAL.pdf](https://www.allea.org/wp-content/uploads/2018/06/ALLEA-ALbanian-European-Code-of-Conduct-for-Research-Integrity_FINAL.pdf)

Projekt – ligj “Për kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, botuar në faqen zyrtare web të MASR në linkun: [http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/KODI\\_ETIK.pdf](http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/KODI_ETIK.pdf).

Sipërmarrja e biznesit dhe institucioni i arsimit të lartë partner në projekt duhet të tregojnë vëmendje të veçantë për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale dhe të paraqesin evidencë bindëse apo masat për të garantuar mundësinë e shfrytëzimit komercial të produktit apo shërbimit inovativ që ka krijuar (shpesh herë e njohur si liria për të vepruar (angl. freedom to operate)).

### 6.3. Konflikti i interesit dhe konfidencialiteti

Si pjesë e procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, AKKSHI do të ndajë përmbajtjen e aplikimeve për grante me ekspertë të brendshëm dhe/ose të jashtëm për të vlerësuar meritat e secilit aplikant dhe respektimin e kërkesave të përshkruara në këtë program. AKKSHI do të përpiqet të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të dhënë në një aplikim, por ***aplikanti është përgjegjës për identifikimin specifik të të gjitha informacioneve konfidenciale brenda aplikimit për të cilat ai gjykon që nuk duhet të ndahen me të tjerë***. Nëse gjykohet e nevojshme nga paneli shqyrtues, aplikantëve mund t'u kërkohet të dorëzojnë informacione ose dokumentacion shtesë dhe/ose të paraqesin propozimin e tyre dhe informacione të tjera relevante të shqyrtuesit përpara se të merret një vendim për financimin. Në çdo rast, aplikuesit, vlerësuesit dhe stafi teknik zbaton parimet ruajtjes së konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

## KREU 7 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### 7.1. Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja e projekteve PTI dhe vlera e financimit përcaktohet në Vendimin e Bordit të Administrimit të AKKSHI për miratimin e Thirrjes për aplikime.

### 7.2. Forma/fokusi i PTI

Në varësi të qëllimit dhe objektivave, mund të jetë:

#### *a. Studim fizibiliteti*

Përmes projekt-propozimit të paraqitur dhe grantit të përfituar, ju ofrohet sipërmarrjeve të biznesit mundësitë që të shqyrtojnë leverdishshmërinë (fizibilitetin) shkencor apo teknik dhe potencial tregtar të një ideje inovatore në fushën e produkteve, shërbimeve apo modeleve të reja të biznesit dhe për të hartuar më tej një Plan – Biznesi që do të zgjerojë e shtrijë këtë produkt inovativ në treg. Aktivitetet e përfshira në projekt-propozimin e paraqitur mund të jenë:

- analizë risku;
- studime tregu;
- përfshirja e klientëve apo përdoruesve të produktit apo shërbimit të ri;
- analiza e kuadrit rregullator e regjimit të standarteve për produktin apo shërbimin e ri;
- administrimi i aspekteve të pronësisë intelektuale, si dhe,
- gjetja e partnerëve apo vlerësimi i leverdisshmërisë (fizibilitetit)

Qëllimi i sipërmarrjeve të biznesit aplikuese do të jetë hartimi i një projekti solid me potencial të lartë inovacioni në përputhje me strategjinë Europiane apo strategjinë globale të orientuar nga tregu. Projekt-propozimi duhet të mbështetet mbi një plan-biznesi si dhe të hartojë specifikime në një mënyrë sa më të qartë se cili do të jetë rezultati i projektit.

### ***b. Nga Koncepti tek Tregu***

Në këtë fazë përmes grantit që i ofrohet projektit, bëhet e mundur që sipërmarrja e biznesit të zhvillojë konceptin e saj të biznesit në një produkt, shërbim apo proces që është i gatshëm të dalë në treg në përputhje me strategjinë e rritjes e fuqizimit të kompanisë tij/saj.

Në këtë fazë projekt-propozimi mund të përfshijë aktivitete të tilla si:

- eksperimentimi;
- prototipin e produkteve,
- vlerësimin,
- demonstrimin si dhe testimin e produktit,
- shërbimin apo modelin në kushte reale dhe nxjerrjen e tij në treg.

Projekt propozimi i paraqitur, nga koncepti tek tregu, duhet të jetë i mbështetur një plan strategjik biznesi dhe duhet të specifikojë rezultatin e projektit dhe kriterin për sukses ashtu si edhe impaktin e kompanisë në termat sasiorë e cilësorë (psh. qarkullimi vjetor, punësimi, madhësia në treg, administrimi i Pronësisë Intelektuale, pagat, rikthimi i investimit, fitimi).

### ***c. Komercializimi***

Komercializimi është procesi i sjelljes së produkteve ose shërbimeve të reja në treg. Ai mund të përfshijë prodhimin, shpërndarjen, marketingun, shitjet, mbështetjen e klientit dhe funksione të tjera kyçe kritike për arritjen e suksesit tregtar të produktit ose shërbimit të ri.

AKKSHI